



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 21
Prishtinë, më 10.03.2009 ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. N- 225

P R O C E S V E R B A L

nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Fatmire Berisha, Adem Hajdaraj, Hestet Cakolli, Gani Buçinca dhe Dragan Dimiq .

Munguan: Enis Kervan, Mark Krasniqi, Donika Kadaj-Bujupi dhe Memli Krasniqi.
Në mbledhje morën pjesë ministri i Kulturës Rinisë e Sportit Valton Beqiri dhe Skender Boshtrakaj udhëheqës i Zyrës për Integritim Europian në Ministrinë e Kulturës.

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu, kryetar i Komisionit.
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Takim me ministrin Valton Beqiri lidhur me zbatueshmërinë e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.**
- 3. Të ndryshme.**

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes.

Lidhur me pikën e tretë të rendit të ditës, anëtari i Komisionit Adem Hajdaraj kërkoi që të debatohet çështja e ngritur e Doktoraturës së Magjistrave të Degës së Stomatologjisë.

Me këtë propozim u pajtuan anëtarët e Komisionit.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes të datës 10.02.2009.

2. Takim me ministrin Valton Beqiri lidhur me zbatueshmërinë e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Kryesuesi njoftoi ministrin se në kuadër të monitorimit të zbatueshmërisë të ligjeve në fuqi, Komisioni ka filluar me shqyrtimin e monitorimit të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, si një ligj i rëndësishëm së veçantë. Komisioni ka shqyrtuar dhe ka debatuar edhe me përfaqësuesin e ministrisë lidhur me mënyrën e implementimit dhe vështirësitë që dalin për mos zbatimin e këtij ligji i cili është aprovuar nga ana e Kuvendit të Kosovës në vitin 2006.

Shqyrtimi i zbatimit të ligjit ka për qëllim që pas analizave të bëhen një raport për Qeverinë, Ministrinë e Kulturës, por edhe për grupet e interesit, veprimtaria e të cilave është e ndërlidhur me këtë Ligj.

Ministri Valton Beqiri prezantoi para Komisionit një pasqyrë të gjerë rreth vështirësive që dalin për moszbatimin e këtij Ligji.

Ai theksoi se zbatimi i këtij Ligji është i ndërlidhur me çështjen e formimit të Zyrës për Mbrojtjen e të Drejtave të Autorit, e cila ende nuk është formuar.

Në nenin 169.1 të këtij ligji thuhet se Qeveria do ta themelojë Zyrën e të Drejtave të Autorit, por nuk dihet se në kuadër të kujt do të funksionojë kjo Zyrë pasi Ligji nuk e specifikon një gjë të tillë.

Sfidë tjetër për mos implementimin e Ligjit është edhe administrimi kolektiv si dhe çështja e regjistrimit të veprës.

Si sfidë të tretë ministri përmendi Gjykatat dhe mediatorët, të cilët sipas tij kanë nevojë për trajnime dhe profesionalizim të mëtutjeshëm në këtë fushë.

Çështje tjetër sipas ministrit është ngritja e kapaciteteve administrative të Zyrës për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Implementimi i këtij Ligji bartë me vete edhe një kosto të lartë buxhetore, andaj është e nevojshme që kjo çështje të shtrohet për zgjidhje me rastin e rishikimit të buxhetit.. Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, është një nga prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, në kuadër të Planit të Qeverisë për Partneritet Evropian, por në mungesë të ekspertizës së nevojshme, në këtë fushë ende nuk janë arritur rezultatet e dëshirueshme, në krijimin e mekanizmave administrative për zbatim të ligjit.

Sa i përket plotësimit dhe amendamentimit të Ligjit ministria konsideron që kjo mund të bëhet pas themelimit të Zyrës së të Drejtave të Autorit, the fillimit të zbatimit të plotë të Ligjit nëse një gjë është e domosdoshme për funksionim të tij.

Ministria e kulturës gjatë vitit 2008 ka hartuar draft rregullore për formimin e Zyrës për mbrojtjen e drejtave të autorit në të cilat janë përfshirë zgjidhje nga Legjislacioni Evropian, si dhe një varg të draft Rregulloreve për çertifikimin e Organizatave për menaxhim kolektiv, draft Rregullat për anëtarët e Bordit Këshillëdhënës, dhe Model Statuti për organizatat për menaxhim kolektiv.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka kontribuar edhe në hartimin e Strategjisë së Kosovës për Pronën Intelektuale, në pjesën e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta, si dhe një varg dokumentesh të rëndësishme të udhëhequr nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Në këtë pjesë të detyrave ministri konsideron që ndihma e Komisionit, është e një rëndësie të veçantë në hapat që do të ndërmerren në të ardhmen për zbatimin e këtij Ligji.

Anëtarët e Komisionit në vazhdim kërkuan sqarim nga ministri për çështjet që ndërlidhen me zbatimin e këtij ligji.

Drita Kadriu vlerëson se Ligji është i rëndësishëm së veçantë, edhe pse i miratuar në vitin 2006 ende nuk po zbatohet në praktikë, ndërsa kërkoj sqarim nga ministri lidhur me harmonizimin e dy pikave të nenit 169 të këtij ligji, brenda Qeverisë. Neni 169.1 i këtij Ligji parasheh se Qeveria do ta themelojë Zyren e të Drejtave të Autorit, në kuadër të kujt do të funksionojë kjo Zyrë Qeverisë apo Ministrisë.

Gjithashtu kërkon sqarim lidhur me nenin 169.2 si dhe sa ka arritur ministria të nxjerrë aktet nënligjore sipas këtij neni.

Ministri theksoi se lidhur me çështjen e themelimit të Zyres do të debatojë në mbledhjen e ardhshme të Qeverisë me qëllim të sqarimit të dilemave rreth këtij neni. Kjo do të mund të bëhet me një udhëzim administrativ ku përgjegjësinë rreth këtij neni ta marrë Ministria e Kulturës. Me qëllim të kordinimit të punëve ministria gjatë vitit 2008 ka hartuar draft rregullore për formimin e Zyres për mbrojtjen e drejtave të autorit si dhe një varg të draft Rregulloreve për certifikimin e organizatave për menagjim kolektiv, draft Rregullat për anëtarët e Bordit Këshilldhënës, dhe Model Statuti për organizatat për menagjim kolektiv.

Adem Hajdaraj kërkon sqarim lidhur me ndryshimin e llogos së Ligjit pasi siq dihet ky ligj funksionon me llogon e vjetër.

Çështja e ndërrimit të llogos së Ligjit sipas ministrit është një çështje teknike e cila duhet të përfundohet në një të ardhme të afërt.

Gani Buçinca konsideron se duhet saktësuar përgjegjësitë si dhe të përcaktohet kostoja financiare për zbatimin e ligjit.

Ai mendon se me amendamentimin e ligjit do të qartësoheshin shumë çështje se kush do ta jap të drejtën e autorësisë për vepra të ndryshme, se a do të kenë ekspertizë të mjaftueshme shoqatat për mbrojtjen e të drejtës autoriale kur dihet se pirateria ka marrë hov, Në aspektin e amendamentimit të Ligjit vlerëson se do të kontribuonte shumë përvoja e ligjit slloven për të drejtat e autorit.

Lidhur me sferën e qëndrueshmërisë financiare të mediave lokale mendon se duhet të parashihet një dispozitë me të cilën do të liroheshin këto media nga pagesa për të drejta autoriale.

Ministri lidhur me këte tha se Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, është analizuar në kuptim të përshtatshmërisë me konventat dhe përvojat ndërkombëtare dhe

ka për bazë ligjin kroat i cili ka dhënë rezultate të konsiderueshme në këtë shtet. Sa i përket autorësisë, kjo është një çështje e rëndësishme së madhe, ndërsa fenomeni i piraterisë duhet të ndërpritet ngase i dëmton editorët producentët dhe autorët.

Sa i përket çështjes së problematikës së mediave lokale, ministri tha se Ligji e trajton edhe këtë sferë dhe në këtë kontest do të gjendet një zgjedhje që i përket mediave lokale si pronë intelektuale.

Fatmire Berisha kërkoi sqarim se si ndërlidhet ky Ligj me Ministrinë e Tregëtisë dhe Industrisë si dhe me Ministrinë e Drejtësisë duke pasur parasysh se në draftimin e Strategjisë të së drejtës autoriale ka marrë pjesë edhe Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë. Ajo kërkoi sqarim edhe lidhur me implikimet buxhetore të këtij Ligji sa janë përafërsisht shpezimet buxhetore për zbatimin e këtij Ligji.

Ministri sqaroi se sa i përket pronës intelektuale dhe autoriale, mbrojtja e kësaj të drejte kanë të bëjë me shumë sfera në të cilat janë të implikuara edhe Ministria e Drejtësisë dhe ajo e Tregëtisë dhe Industrisë.

Ndërsa sa i përket Implementimit Ligji bartë me vete edhe një kosto të lartë buxhetore, andaj është e nevojshme që kjo çështje të shtrohet për zgjidhje me rastin e rishikimit të buxhetit.

Skender Boshtrakaj në vijim spjegoi lidhshmërinë e Strategjisë për pronën Intelektuale si një Srtategji e gjërë e cila kishte me i pru të gjitha institucionet në një dokument, ku do duhej të inkuoroheshin edhe disa ministri të tjera ngase këtë hyjnë shumë fusha.

Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë ka udhëheq procesin dhe ka marrë pjesë në hartimin e kësaj Srtategjie. Riaktivizimi i një strategjie do të përfshinte të gjitha institucionet në një dokument.

Pas debatit të gjerë në kuadër të monitorimit të zbatimit të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, Komisioni nxorri këtë:

P ë r f u n d i m

1. Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta nuk është duke u zbatuar.
2. Nuk është themeluar Zyra për pronësi intelektuale që parashihet në nenin 169.1 të Ligjit.
3. Nenit 169.1 lidhur me themelimin e Zyrës për pronësi intelektuale për Ministrinë është i paqartë, andaj kërkohet interpretimi: i kujt është detyrimi ligjor për themelimin e zyrës.
4. Nuk janë nxjerrë aktet nënligjore që parashihen me nenin 169.2. në periudhën e paraparë me Ligj.
5. Qeveria nuk ka nda buxhet për zbatimin e këtij Ligji në vitin 2009.
6. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk i ka ngritë strukturat e nevojshme administrative për fillimin e zbatimit të këtij Ligji.
7. Ligji është në përputhje me Legjislacionin e BE-së.
8. Ministria nuk ka paraparë plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit në Strategjinë Legjislative gjatë këtij viti

Ky raport me përfundim të Komisionit do ti dërgohet Qeverisë, Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit si dhe Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Të ndryshme

Komisioni shqyrtoi shkresën e kandidatëve të Degës së Stomatologjisë së Universitetit të Prishtinës e cila ka të bëjë me zbatimin e procedurave administrative për vijimin e Doktoraturës për Magjistrat e shkencave të Degës së Stomatologjisë.

Anëtarët e Komisionit vlerësuan se lidhur me këtë çështje duhet të debatohet në mbledhjen e ardhshme e cila do të mbahet më 25.3.2009 në orën 10,00 .

Në këtë takim lidhur me këtë çështje do të ftohen ministri i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë Enver Hoxhaj si dhe Rektori i Universitetit të Prishtinës Enver Hasani.

Mbledhja përfundoi në orën 12,45.

Kryetari i Komisionit

Agim Veliu